



**SYNAPSE**

Advanced Technology Services

**Profil Kompanie**

---

## Informacion i Përgjithshëm

Synapse ATS Sh.p.k, është një kompani që ofron shërbime, zgjidhje dhe edukim në fushën e teknologjisë së informacionit dhe komunikacionit (TIK). Oferta jonë përfshin konsulencën, integrimin e sistemeve, trajnimet, shërbimet e hostuara dhe të menaxhuara.

---

## Misioni

Misioni ynë është të ofrojmë zgjidhje, konsulencë dhe trajnime të standardeve ndërkombëtare në fushën e TIK.

## Vizioni

- Të nxisim dhe drejtojmë inovacionin në fushën e TIK.
- Të jemi kompania lider në tregun lokal si Integrues Sistemesh.
- Të drejtojmë klientët tanë drejt suksesit nëpërmjet njohurive, ekspertizës dhe shërbimeve tona.

## Struktura

Synapse ATS, është strukturuar në tre njësi kryesore:

**Integrimi i Sistemeve:** qëllimi i kësaj njësie biznesi është të ofrojë një sërë shërbimesh të plota, që ndihmojnë klientët tanë të vlerësojnë, planifikojnë, projektojnë, implementojnë dhe të operojnë infrastrukturën IT për të përmbushur qëllimet e tyre të biznesit.

**Shërbimet e Menaxhuara:** i orientuar drejt shërbimeve “cloud”, qëllimi kryesor është të zhvillojmë dhe ofrojmë një tërësi zgjidhjesh që çlirojnë klientët tanë nga implementimet komplekse në ambientet e tyre, që ulin kostot operacionale dhe të mirëmbajtjes si edhe ju mundësojnë atyre shërbimet kudo dhe kur ju duhen.

**Edukimi:** qëllimi kryesor i kësaj njësie është të ofrojë një gamë të gjerë programesh trajnimi në fushën e TIK nëpërmjet dy metodave: integrimin e programeve të trajnimit në programin mësimor akademik të universiteteve për studentët dhe trajnimet intensive për punonjësit e ndërmarrjeve private apo institucioneve qeveritare.

## Zgjidhjet

### Rrjetat

Synapse ATS është i specializuar në zgjidhjet për infrastrukturën e rrjetit. Ne ofrojmë zgjidhje dhe shërbime për teknologji si ruterat, switch-et, sigurinë, menaxhimin dhe zgjidhjet “pa-tel” (wireless). Ne ndihmojmë klientët tanë në ndërtimin e një infrastrukture rrjeti të aftë për të mbështetur dhe ekzekutuar aplikime të zërit dhe videos, të besueshme, lehtësisht të shkallëzueshme dhe që ruan integritetin e të dhënave.

Ne ofrojmë zgjidhje dhe shërbime në teknologjitë e mëposhtëme:

- Ruterat dhe Switch-e
- Sigurinë e Rrjetave
- Menaxhimin e Rrjetave
- Komunikimet Wireless

### Komunikimi i Unifikuar

Synapse ATS është e angazhuar për të kombinuar komunikimin në një rrjet dhe në një zgjidhje të vetme duke ndihmuar në këtë mënyre klientët tanë që të bashkëpunojnë dhe ndërveprojnë më mirë me njëri tjetrin, të ulin koston totale të investimit, të reduktojnë tarifatat operacionale dhe të mirëmbajtjes.

Zgjidhjet tona në këtë fushë përfshijnë teknologjitë e mëposhtëme:

- Telefoni IP/ VoIP
- IM dhe Voice Mail
- Video Konferencat
- Qendrat e Kontaktit

Synapse ATS është teknologjikisht e pavarur dhe mund të integrojë dhe suportojë zgjidhje nga prodhuesit kryesorë si edhe zgjidhje “Open Source”. Ne jemi të orientuar drejt nevojës së klientit dhe suksesit të tyre, prandaj gjithmonë propozojmë për klientët zgjidhjen e duhur, duke patur parasysh nevojat, infrastrukturën ekzistuese dhe kërkesat për të ardhmen.

## Data Center

Synapse ATS ofron një gamë të gjerë shërbimesh dhe teknologjishë për ndërtimin, konsolidimin, optimizimin, virtualizimin dhe migrimin e Data Center.

Oferta jonë adreson të gjitha aspektet e një Data Centeri, duke përfshirë:

- Ambientin: planifikimin e instalimeve, energjinë, ftohjen, sigurinë fizike
- Infrastrukturën e Sistemeve: serverat, rrjetin, pajisjet e ruajtjes së informacionit dhe sigurinë e informacionit
- Menaxhimin e shërbimeve dhe operacioneve

## Siguria Fizike

Sistemet e Sigurisë Fizike ndihmojnë klientët tanë të mbrojnë njerëzit dhe asetet e tyre. Kjo linjë zgjidhjesh përfshin instalimet dhe konfigurimet e kamerave të vëzhgimit, video regjistratorëve, monitorimit të centralizuar, sistemet e kontrollit të aksesit, sistemet e alarmit dhe zgjidhjeve analitike video. Linja jonë e shërbimeve dhe zgjidhjeve për Sistemet e Sigurisë Fizike përfshin:

- Sistemet e Video Survejimit
- Sistemet e Akses Kontrollit
- Menaxhimi i Kohës dhe Pjesmarrjes
- Menaxhimi i Vizitorëve

## Shërbimet

### Shërbimet Profesionale

Synapse ATS ofron një gamë shërbimesh të plota që përfshijnë vlerësimin, planifikimin, projektimin dhe operimin e një infrastrukture IT.

Këto shërbime përfshijnë:

#### • Konsulenca

Shërbimi yne i konsulencës ju ofron njohuritë dhe mjetet e nevojshme për t'ju ndihmuar që të merrni vendime strategjike lidhur me infrastrukturën tuaj IT. Ne punojmë me klientët për të kuptuar dhe vlerësuar gjendjen ekzistuese të infrastrukturës IT, rekomandojmë përmiresimet e nevojshme dhe bëjmë të qartë ndikimin që do ketë integrimi i teknologjive të reja në biznesin e klientit.

Skuadra jonë e konsulentëve mund t'ju ndihmojë:

- Të kuptoni dhe vlerësoni situatën ekzistuese të infrastrukturës
- Të përcaktoni zgjidhjen më efektive për nevojat tuaja
- Të identifikoni prioritetet për veprim
- Në implementimin dhe menaxhimin e zgjidhjes

#### • Projektimi

Synapse ATS mund të projektojë zgjidhje IT bazuar në nevojat tuaja. Skuadra jonë e ekspertëve, me vite eksperiencë në fushën e IT-së dhe njohuri të gjera në teknologji dhe biznes, mund t'ju ndihmojë të përcaktoni, projektoni dhe konfiguroni nje zgjidhje që adreson të gjitha karakteristikat dhe funksionalitetet që plotësojnë objektivat tuaja teknike dhe të biznesit.

## Metodologjia jonë për projektimin e një zgjidhje përfshin:

- Analiza e Nevojave të Biznesit
- Zhvillimi i Arkitekturës së Zgjidhjes
- Prova e Konceptit
- Zhvillim i Planit të Implementimit

### • Implementimi

Një sistemi i besueshëm nuk varet vetëm nga hardware-*i* dhe software-*i* që ju zgjidhni, por shërbimi i implementimit është vendimtar për të siguruar që ky sistem do të jetë funksional, i besueshëm, i optimizuar, i vlefshëm dhe i dokumentuar.

## Shërbimi i Implementimit të Synapse ATS përfshin proceset e instalimit dhe konfigurimit si mëposhtë:

- Mbledhje të informacionit “on-site” dhe përgatitje të ambientit
- Instalim Fizik i Pajisjeve
- Konfigurim i Pajisjeve dhe Sistemeve
- Testimi dhe Vlerësimi
- Dokumentim i Detajuar Teknik
- Trajnim i Përdoruesve dhe Administratorëve të Sistemeve

### Mirëmbajtja, Suporti dhe Shërbimet “Outsource”

Bazuar në eksperiencën e stafit lokal, në suportin e partnerëve tanë, si edhe në kërkesat e tregut, ne kemi krijuar një tërësi shërbimesh mirëmbajtjeje, suport i dhe “outsource”, që mund të ndihmojnë klientët tanë të reduktojnë kostot administrative të IT-së, të rrisin produktivitetin dhe vlefshmërinë e shërbimeve.

## Synapse ATS mund të ofrojë:

- Shërbim “Help Desk-*u*”
- Zhvillim Aplikacionesh
- Monitorim të Rrjetit dhe Infrastrukturës
- Shërbim Suporti dhe Garancie



**Synapse ATS**

**Adresa:** Rr."Sotir Kolea", Tirana, Albania

**web:** [www.synapse.al](http://www.synapse.al)